



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 59/09**

**Prishtinë, më 9.09.2009, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Armend Zemaj, Riza Smaka dhe Hajdin Abazi.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani dhe Müfera Şinik.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Hasan Isufaj zv. drejtor Dep.të Buxhetit në MEF-it, pjesëmarrës nga GTZ, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 22.07.2009 dhe 24.07.2009;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2628 Do-1644 dt. 07.09.2009 së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për aprovim të numrit të punëtorëve për Ekipet Përgatitore Komunale I ftuari: Agim Krasniqi, Drejtor i Departamentit të MEF-it;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2629 Do-1645 dt. 07.09.2009 së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për aprovim të transferit të mjeteve financiare nga “Programi i Zgjedhjeve” nga kategoria ekonomike paga dhe mëditje në “Programin e Sekretariatit” në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2630 Do-1645 dt. 07.09.2009 së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për rregullimin e numrit të punëtorëve në Autoritetin e Aviacionit Civil**
- 6. Shqyrtimi i Projekt-Strategjisë nr. 03/2433-DO-1525 dt. 25.06.2009 së Qeverisë së**

## **Republikës së Kosovës Kundër Korrupsionit 2009 – 2011**

- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente;**
- 8. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari**, përshëndeti të pranishmit dhe urojë mirëseardhje në sesionin e ri vjeshtor. Gjithashtu përshëndeti përfaqësuesin e GTZ dhe falënderojë për mbështetjen që do t'ia ofrojë komisionit. Në vazhdim kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

**Riza Smaka**, theksoi se do të ishte mirë që komisioni të kërkojë sqarim nga Kryesia për moszbatimin e vendimeve që ka marrë ky komisioni, lidhur me zbatimin e buxhetit të Kuvendit.

**Kryetari**, në përgjigjen e pyetjes së parafolësit, theksoi se për çështjen e mosrespektimit të rekomandimeve të komisionit lidhur me zbatimin e buxhetit të Kuvendit dhe agjencioneve tjera të pavarura, ka biseduar me Kryetarin dhe Sekretarin e Kuvendit, dhe ka kërkuar që këto probleme të diskutohen në një mbledhje të përbashkët. Nëse nuk merren parasysh kërkesat e arsyeshme të komisionit, do të kërkohet që për këto çështje të organizohet një debat i hapur në seancën plenare.

**Besa Gaxherri**, theksoi se çështja e buxhetit të Kuvendit duhet ndahet nga ajo e agjencioneve të pavarura. Sa i përket buxhetit të Kuvendit është aprovuar me rastin e miratimit të buxhetit 2009, dhe si rezultat i moszbatimit i tij, po shkelet ligji dhe rregullorja.

**Armend Zemaj**, po ashtu mbështeti kërkesën e z. Smaka dhe kërkoi që kryetari të interesohet për ecjen e procedurës rreth rekomandimeve të komisionit për zbatimin e buxhetit të Kuvendit.

**Haki Shatri**, propozoi që në mbledhjen tjetër, ndër pika tjera të jetë edhe shqyrtimi i raporti gjashtëmujor të buxhetit për vitin 2009.

**Kryetari**, konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, dt. 22.07.2009 dhe 24.09.2009**

**Kosara Nikolic**, theksoi se në procesverbalin e dt. 24.09.2009 në diskutimin e saj është shkruar shumë pak në krahasim me atë që është thënë nga ajo. Do të ishte mirë që nëse stafi nuk ka arritur të regjistroj shënimet, të konsultohet me atë dhe të përfshihet diskutimi i saj në procesverbal.

**Kryetari**, konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të kaluara miratohen, me vërejtjet e znj. Nikolic, të cilat duhet inkorporohen në procesverbalin e dt. 24.07.2009.

### **3. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2628 Do-1644 dt. 07.09.2009 së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për aprovim të numrit të punëtorëve për Ekipet Përgatitore Komunale**

**Kryetari**, theksoi se kjo kërkesë ka të bëjë lejimin e numrit të punëtorëve për ekipet përgatitore për komunat e reja, buxheti i së cilave ekziston.

**Hasan Isufaj**, theksoi se kemi pranuar kërkesën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për lejimin e numrit të punëtorëve për ekipet përgatitore dhe pasi kemi vërejtur se mjetet buxhetore ekzistojnë, konform ligjit për buxhetin, e kemi procedua në Kuvend për miratim.

**Besa Gaxherri**, theksoi se pasi që me rishikimin e buxhetit është lejuar shuma buxhetore për këto ekipe përgatitore, komisioni duhet përkrah miratimin e kësaj kërkesë.

**Kosara Nikolic**, theksoi se i mungon materiali i bashkangjitur në gjuhën serbe i kësaj kërkesë dhe i kërkesave tjera që do të diskutohen në vijim.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

- I. Miratohet kërkesa e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për lejimin e numrit të punëtorëve në ekipet përgatitore komunale deri në momentin e mbajtjes së zgjedhjeve të reja komunale, për ushtrimin e punëve administrative të përcaktuara me Ligjin 03/L-041 për kufijtë administrativ komunal.
  - II. Mjetet financiare për pagesën e ekipeve janë të miratuara me Ligjin nr. 03/L-167 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit br. 03/L-105 për Buxhetin Republikës së Kosovës për vitin 2009, në kategorinë ekonomike “pagat dhe mëditjet”, në shumën prej 173,646 €
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2629 Do-1645 dt. 07.09.2009 së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për aprovim të transferit të mjeteve financiare nga “Programi i Zgjedhjeve” nga kategoria ekonomike paga dhe mëditje në “Programin e Sekretariatit” në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**

**Kryetari**, theksoi se kjo kërkesë ka për qëllim të korrigjojë një lëshim që është bërë nga Dep. Buxhetit lidhur me transferin e mjeteve të KQZ-së në programin e caktuar. Kërkohet që mjetet të barten nga programi “Zgjedhjet” në programin “Sekretariati”, në kategorinë paga dhe mëditje.

**Hasan Isufaj**, theksoi se Qeveria ka marrë vendim që për përdhunë gjashtë mujore për stafi e sekretariatit të KQZ-së, të lejohen shtesat. Mirëpo gjatë përgatitjes së tabelave të buxhetit të rishikuar, është bërë gabim në transferin e kësaj shume nëpër programe.

**Besa Gaxherri**, theksoi se stafi i KQZ-së është i papërgatitur. Kur kemi shqyrtuar buxhetin e KQZ-së dhe kemi vërejtur se në mungesë të profesionalizmit nuk kanë në gjendje ta arsyetojnë si duhet kërkesat ne tyre.

**Kryetari**, theksoi se, sa i përket çështjes së parashtruar, gabimi është bërë në Dep. e buxhetit të MEF-it dhe jo nga GTZ-ja.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me tetë vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenim (znj. Besa Gaxherri) Komisioni nxori këtë:

## REKOMANDIM

- I. Miratohet kërkesa e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në shumën prej 88.200 € nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve programi (142) “Zgjedhjet”, në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve, programi (141) “Sekretariati”, për pagesën e mëditjeve për nëpunësit e departamentit të sekretariatit.
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2630 Do-1645 dt. 07.09.2009 së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për rregullimin e numrit të punëtorëve në Autoritetin e Aviacionit Civil**

**Kryetari**, theksoi se edhe kjo kërkesë ka ardhur si rezultat i gabimit të bërë në MEF-i me rastin e evidentimit të numrit të punëtorëve për Aviacionin Civil. Buxheti dhe numri i punëtorëve për këtë agjencion është aprovuara, por se radhitja e numrit të punëtorëve është bërë gabim në tabelat buxhetore. Në vend se të shkruhen 21 janë shkruar 8 punëtorë. Prandaj shifra 8 duhet korrigjohet në 21.

**Riza Smaka**, theksoi se problemet e përcaktimit të pagave të agjencioneve të pavarura po shfaqen vazhdimisht, që tregon nevojën e miratimit të ligjit për paga, dhe brenda tij të rregullohen këto çështje. Deri atëherë, propozoi që këto paga të quhen “paga të përkohshme”.

**Hasan Isufaj**, theksoi se në bazë të ligjit për aviacionin civil, drejtori harton organogramin bënë pranimin e punëtorëve, ndërsa për lartësinë e pagave të tyre vendos MEF-i. Meqë gabimi është bërë

**Haki Shatri**, theksoi se po të analizohet kërkesa e Aviacionit Civil, shifet se buxheti është aprovuar pa evidentimin e numrit të punëtorëve. Pas një llogarie matematikore, për këtë punëtorë rroga mesatare është 1600€ që është e papranueshme.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se pajtohet që të përmisohet ky gabim, por se nuk mund të mbyllet sytë nga materiali i bashkangjitur dhe për shifrat e larta të pagave të punëtorëve të agjencionit. Është e papranueshëm rritja e pagave të këtyre punëtorëve, kur dihet se rroga mesatare është 1700€ Kërkoj që në rekomandimin komisionit, përveç përkrahej së kërkesës për korrigjimin e numrit të punëtorëve, të shkruhet edhe një pikë me të cilën ftohet Ministri për të dhënë sqarime në komision për pagat e punëtorëve të aviacionit civil.

**Hajdin Abazi**, kemi të bëjmë me paga shumë të larta. Duke ditur situatën edhe me rregullatorët tjerë, të dalim me një propozim që me ligjin për pagat e shërbyese civil, të rregullohet edhe çështja e pagave e rregullatorëve të pavarur.

**Armend Zemaj**, theksoi se pajtohet me rregullimin e numrit të punëtorëve, por se duhet sqaruar çështja e rritjes së pagave. Nëse MEF-i ka vendosur që paga e këtyre punëtorëve të jetë në një shumë të caktuar, atëherë si ka mundur që drejtori të rrit pagat në këto shifra. Kjo shtrën nevojën që të ftohet Ministri në Komision dhe të sqarohet çështja e pagave të punëtorëve të këtij agjencionit.

**Besa Gaxherri**, propozoj që MEF-i të rishqyrtojë edhe njëherë këtë çështje, të rregullojë problemin e pagave konform ligjit, pastaj të riprocedohet edhe njëherë në Kuvend kërkesa. Në këtë situatë nuk mund të aprovohet as shtimi i punëtorëve dhe as pagat marramendëse të tyre.

**Myrvete Pantina**, theksoi se kërkesës do të duhej të bashkëngjitej sqarimi, që arsyeton rritjen e pagave të punëtorëve të aviacionit civil.

**Kryetari**, theksoi se nuk kemi kërkesë për shtim të buxhetit, por përmisimin gabimit teknik që ka të bëjë me numrin e punëtorëve. Prandaj objekt diskutimi dhe votimi është kërkesa e MEF-it dhe jo e Aviacionit Civil. Ligji për Aviacionin Civil përcakton se ME-i vendos për nivelin e pagave. Kjo çështje ka qenë në komisionin me rastin e rishikimit dhe ka kaluar pa u vërejtur. Tani objekt diskutimi është numri i punëtorëve dhe jo shuma buxhetore.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## REKOMANDIM

- I. Miratohet kërkesa e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për rregullimin e numrit të punëtorëve nga 8 në 21 në Autoritetin e Aviacionit Civil, me qëllim të plotësimit të tabelës buxhetore 2a të Ligjit nr.03/L-167 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.
- II. Mjetet financiare për pagesën e punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil janë të miratuara me Ligjin nr. 03/L-167 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin për vitin 2009.
- III. Të ftohet Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në mbledhjen e komisionit, për të dhënë sqarime rreth nivelit të pagave të punëtorëve të Aviacionit Civil.

## **6. Shqyrtimi i Projekt-Strategjisë nr. 03/2433-DO-1525 dt. 25.06.2009 së Qeverisë së Republikës së Kosovës Kundër Korrupsionit 2009 – 2011**

**Kryetari**, theksoi se kemi pasur Projekt-strategjinë dhe të njëjtën e ka kthyer Kuvendi me arsyetimin se nuk përmban planin operativ. As tani nuk përfshihet një plan i tillë, sepse obligimet për planet operative i mbajnë institucionet përkatëse.

**Myrvete Pantina**, vlerësoi arsyeshmërin për ekzistimin e një strategjie kundër korrupsionit. Sa i përket strategjisë së parë që është kthyer nga Kuvendi, ndër vërejtjet tjera, është kërkuar që ajo të përmbaj afatet dhe treguesit e matshëm, që tregojnë gjendjen dhe nivelin e korrupsionit. Tani me modifikimet e bëra, kjo strategji i përmban këto kushte, megjithëse disa afate kanë kaluar. Për disa aktivitetet duhet caktuar afatet. Ndërsa matja e treguesve do të duhej bërë çdo gjashtë muaj.

**Kryetari**, duke u kyçur në diskutimin e parafolësës, theksoi Ligji kundër korrupsionit përcakton kohën e raportimit.

**Besa Gaxherri**, theksoi se pajtohet se korrupsionin nuk mund ta luftojë Qeveria vetë, pa ndihëm e akterëve tjerë. Në këtë drejtim kërkohet një plan operativ, përmes së cilit Qeveria duhet luaj rolin e mbikëqyrësit ndaj organeve tjera ekzekutive dhe të kërkoj llogari prej tyre se qfarë kanë bërë në luftimin e korrupsionit. Konform detyrimeve ligjore dhe në bazë të planit operativ dhe përcaktimit të afateve, Qeveria duhet kërkojë përgjegjësi ndaj organeve të caktuar ekzekutive në luftën kundër korrupsionit.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se njëherë është dashur të aprovohet strategjia në Kuvend pastaj plani i veprimt. Pasi që kjo strategji është objekt diskutimi edhe në komisionet tjera, të fushave të caktuara, propozojë që të koncentrohen shqyrtimin e saj nga aspekti financiar dhe në bazë të kësaj t'i rekomandohet Kuvendit.

**Riza Smaka**, theksoi se si komision, duhet të koncentrohemi në implikimet shtesë buxhetore që mund të shkaktojë kjo projekt strategji, dhe nëse nuk ka të miratojmë atë. Ndërsa për pjesën tjetër të merren komisionet tjera dhe Kuvendi.

**Haki Shatri**, propozoi që rekomandimi i komisionit të jetë, se projekt-strategjia nuk përmban implikime buxhetore dhe i rekomandohet Kuvendit ta shqyrtojë atë.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni e shqyrtoi nga aspekti buxhetor Projekt strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës kundër korrupsionit 2009 -2011, dhe konstatoi se e njëjta nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

- II. Rekomandohet që Kryesia e Kuvendit, për seancën plenare të Kuvendit, të radhit në rend të ditës për shqyrtim Projekt strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës kundër korrupsionit për vitin 2009 -2011.

**7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

**REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**8. Të ndryshme.**

8.1. Kryetari kërkoi nga grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit për tatimin mbi korporatat të fillojë punën dhe të përgatis raportin për komisionin. Pasi që Shkumbin Demalija nuk është më anëtar i këtij komisioni, propozoi që në vend të tij të jetë Safete Hadërgjonaj.

8.1. Kryetari theksoi se megjithëse komisioni ka aprovuar në parim projektligjin për tatimin në të ardhurat individuale, nuk ka krijuar grupin punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e tij. Propozoj që anëtar të këtij grupi të jenë: Haki Shatri (kryesues), Myrvete Pantina dhe Hajdin Abazi. Propozimi u përkrah njëzëri.

8.3. Kryetari njoftoi për dorëzimin e raportit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Njëkohësisht i njoftoi anëtarët për marrjen e raporteve auditimit të agjencioneve tjera. Propozoi që ky raport të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit. Propozimi u përkrah njëzëri.

8.4. Gjithashtu kryetari njoftoj me kërkesën e përfaqësuesve të misionit të FMN-së për tu takuar me anëtarët e komisionit për të diskutuar për politikën fiskale në Kosovë. Takimi është planifikuar të mbahet me 15.09.2009 prej orës 11:15. Kërkoj nga anëtarët të jenë të pranishëm në këtë takim.

Mbledhja e radhës u caktua më, dt. 16.09.2009 prej orës 11:00.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

**Gani KOCI**